

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

Në Tiranë, sot më datë 17.10.2024 (dymijë e njëzetë e katër)

-Roy Garin, i biri i Yariv-it, i dtl. 18.11.1983, lindur në Israel dhe banues në Tiranë, i identifikuar me Pasaportën me Nr. 29030718 i lëshuar nga shteti i Israelit dhe me Nr.personal, I34118004G.

-Ndue Pjetra, i biri i Lazerit, i dtl. 19.11.1962, lindur në Prekal, Shkodër dhe banues në Tiranë, i identifikuar me nr. Personal G21119064W

*të cilët kanë, vendosur themelimin e shoqërisë "KOHAV BALKAN" Sh.p.k, sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe me vullnet të lirë, kërkuan nga unë noteri hartimin e këtij Akt -Themelimi me terma si më poshtë:*



**NENI 1.**

Shoqëria Tregtare "KOHAV BALKAN" Sh.p.k, (në vazhdim Shoqëria) formohet në formën e personit Juridik, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe do të funksionojë në baze të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.

**NENI 2.**

**Emri i shoqërisë**

Emri i shoqërisë do të jetë : "KOHAV BALKAN" Sh.p.k.

**NENI 3.**

**Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

Qëllimi i themelimit të Shoqërisë është qëllim i ligjshëm afarist dhe për përfitim personal, si dhe Krijim zhvillim zyra ndërmjetësimi për pasuritë e Paluajtshme nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate të veçante Franchising; çdo lloj shërbimi në fushat e menaxhimit, të blerjes, shitjes dhe qiradhënies së pasurisë së paluajtshme, të kontabilitetit tregtarë dhe atij të pasurisë së paluajtshme, të fiskalit të titit, të ndërmjetësimit, financimit dhe të drejtës së pasurisë së paluajtshme si dhe çdo lloj veprimi me pasuritë e luajtshme e të paluajtshme në lidhje direkte apo indirekte me qëllimin.

Përshtatja, zhvillimi dhe realizimi i çdo lloj investimi me klientë shqiptar dhe të huaj. Dëdikimi ndaj biznesit për ofrimin e çdo lloj shërbimi, shitje, rishitje komerciale, blerje, shpërndarje, transport, import, eksport të çdo lloj sendi. Blerje, shitje, shkëmbim, lënie me qira, lasë apo çdo lloj forme tjetër të tjetërsimit të se mirave, pronësive etj. Te marrë apo para për borxhe, me ose pa asnjë garanci, dhe të emetojë borxhe obligacione ose japë aksione në formën e obligacioneve, çeqe, karta krediti etj. Te manifestojë, ekzekutojë, realizojë kontrata të çdo lloji për çfarëdo objekti të ligjshëm, të realizojë emetimin e obligacioneve pa limit për sa i përket numrit të tyre, me çdo njeri fizik ose juridik, firmë, biznes apo çdo aktivitet të ligjshëm. Në përgjithësi të realizojë çdo lloj biznesi apo aktiviteti të



ligjshëm, civil apo tregtar. Shërbime sociale bar kafe, restorant, agjenci imobiliare, komsionere, ndërmjetësim, aktivitet ne fushën e siguracioneve TPL, shëndet ne udhëtim, etj, Shoqëria do të ushtrojë dhe çdo aktivitet tjetër tregtar që nuk është i ndaluar nga ligji

shërbime juridiko ligjorë, përfshirë këtu shërbime avokatie, noterie, përmbarimore, ndërmjetësues, psikolog, shërbime të detektivit privat, dhe të gjitha shërbimet të parashikuara nga lista e profesioneve të lira të miratuara me ligj.

Shkolla dhe kurse profesionale deri në dy vite të parashikuara nga ligji i arsimit profesional.

Instalim dhe përdorim i sinjali stikës së radio alarmit dhe të pajisjeve të tjera të vëzhgimit, si GPS, regjistruer audio- video etj.

Projektim dhe instalim i kontrollit të aksesit dhe sigurisë së lartë, integrim i sistemeve, dhe pajisje monitoruese regjistruese të përmasave të ndryshme.

Konsulentë dhe analizë të sigurisë, rikuperim të dhënash nga mjetet e teknologjisë së lartë.

Projektim, furnizim, instalim dhe mirëmbajtja e sistemeve të inteligjencës. Furnizim, instalim, mirëmbajtje e pajisjeve elektronike për përdorime detare.

Furnizim, instalim dhe mirëmbajtje e pajisjeve të telekomunikacionit dhe radio ndërlidhjes. Import eksport me shumice dhe pakicë i materialeve të teknologjisë elektrike dhe elektronike, pajisje për navigacion etj.

Importe-eksporte dhe shitje dhe mirëmbajtje e avionëve dhe pjesëve të tyre. Import-eksport të pajisjeve monitoruese regjistruese për strukturat ligj-zbatuese, policisë, policisë private dhe detektivë privatë.

Trajnim profesional për Arte Marcialë (KUNG FU ËUSHU). Shërbime online, shitje, blerje pajisjesh detektivit dhe programesh kompjuterike, rregullime faqesh interneti online, asistence kompjuterike online, krijim faqesh ëeb online, suport teknik online, programime, ëeb design online, konsulencë netëorking online. Esport -Import shitje te makinash te reja dhe te përdorura si dhe piken për riparimin dhe çdo lloj shërbimi qofte edhe kolaudimin e makinave. Kryerja e Testit të Poligrafit

#### NENI 4.

##### Zyra Qendrore/selia e Shoqërisë dhe degët

Selia qendrore e Shoqërisë, do të jetë në Republikën e Shqipërisë, në adresën: Rruga 5 Maji Njesia Administrative Nr. 8, Rruga 5 Maji, Ish Nish Kimikja, Nr. Pasurie 3/142/ND1, Zona Kadastrale 8340

Shoqëria me miratimin e organeve përkatëse mund të krijojë degë dhe zyra përfaqësimi, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilat do të jenë të lidhura në ushtrimin e aktivitetit të tyre me shoqërinë mëmë.

#### NENI 5.

##### Kapitali i Shoqërisë


Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën (1000) Euro, e cila përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët Themelues. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para dhe/ose në natyrë.

#### NENI 6.

##### Kohëzgjatja e shoqërisë





Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktiviteti fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin e Biznesit.

#### **NENI 7.**

##### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1.Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;

2.Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratoret, i cilët zgjidhen për një afat 5-vjeçar me të drejtë riemërimi:

#### **NENI 8**

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

#### **NENI 9**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 10**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 11**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 12.**

##### **Dispozitat përfundimtare**

Ky Akt Themelimi u redaktua në 4 (katër) kopje me përmbajtje dhe vlera të njejta juridike,

### **ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**Themelues i shoqërisë "KOHAV BALKAN" Sh.p.k. është Roy Garin, i biri i Yariv-it, i dtl. 18.11.1983, lindur në Israel dhe banues në Tiranë, i identifikuar me Pasaportën me Nr. 29030718 i lëshuar nga shteti i Israelit dhe me Nr.personal, I34118004G dhe Ndue Pjetra, i biri i Lazerit, i dtl. 19.11.1962, lindur në Prekal, Shkodër dhe banues në Tiranë, i identifikuar me nr. Personal G21119064W**

**Themeluesit shoqërisë "KOHAV BALKAN" Sh.p.k**

**Roy Garin**

**Ndue Pjetra**

